



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 19 dt. 30.05.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.05.2014, pasi shqyrtoi materialin e vënies në dijeni mbi plotësimin e afateve të ushtrimit të licensës së restauratorit,

VENDOSI:

1. Heqjen e licensës së restaurimit R.SH.1 për shoqërinë “KAN” shpk.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, heqjen e licensës në fushën e restaurimit R.SH. 1, për shoqërinë “KAN” sh.p.k, me drejtues ligjor Z. Adrian Kalamishi.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI